

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6575
E shtunë, 2 prill 2022
çmimi 0.40 €

Myftiu Tërnavë ua uron besimtarëve myslimanë Muajin e Ramazanit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEKIM HAXHIU | FAQE 4

KOSOVA KA SHËNUAR NGEÇJE ME QEVERINË KURTI

- Qytetarët janë zhgënjyer me këtë qeveri, prandaj po ikin nga Kosova



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se gjatë qeverisjes mbi njëvjeçare të kryeministrit Albin Kurti, Kosova ka shënuar ngeçje në të gjitha fushat. Haxhiu ka thënë se qytetarët janë të zhgënjyer me qeverinë Kurti. Në këtë bisedë për "Epokën e re", Haxhiu ka thënë se qeveria Kurti nuk është duke e luajtur rolin ekzekutiv, por atë të vëzhgueses. Ai ka thënë se opozita nuk ka qenë shumë aktive për faktin se kjo qeveri ka pushtet absolut. Në këtë kontekst, ai ka thënë se duhet të binden vetë qytetarët se janë mashtruar nga Kurti. Ndërsa sa i përket iniciativës për tërheqjen e 30 për qind të mjeteve nga Trusti, Haxhiu ka shprehur optimizëm se edhe deputetët e pushtetit do ta përkeqësojnë një iniciativë të tillë

Osmani dhe Konjufca nderojnë të rënët në masakrën e Lybeniqit | FAQE 7



POLICIA GJATË VITIT 2021 KA KRYER 51 OPERACIONE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



"MIRATOHET PLANI" I KRYQIT TË KUQ PËR EVAKUIMET NGA MARIUPOLI | F. 2

KURTI KËRKON HAPJEN E ZYRËS EKONOMIKE BAVAREZE NË PRISHTINË | F. 5

MINISTRI LATIFI: VAKSINIMI, MËNYRA MË EFEKTIVE PËR PARANDALIMIN E COVIDIT | F. 4

EKONOMI



QEVERIA HESHT LIDHUR ME STRATEGJINË PËR ENERGJI | F. 8

SHTYHEN AFATET PËR OBLIGIMET E TATIMIT NË PRONË DHE DEKLARIMIT TË TË ARDHURAVE PERSONALE | F. 8

KULTURË



NJË VIT PA LULËZIM KRASNIQIN, PËRUROHEN DY LIBRA, NJËRI I TIJ, TJETRI PËR TË | F. 6

HRW i bën thirrje Ukrainës të hetojë krime të mundshme të luftës



KIEV, 1 PRILL - Organizata Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut, Human Rights Watch, i ka bërë thirrje Ukrainës që ta hulumtojë secilin krim të supozuar të luftës që mund të kenë kryer trupat e saj pas raportimeve të paverifikuara se ushtarët ukrainas kanë torturuar trupat e zëna ruse prej kur Moska ka nisur sulmin ndaj fqinjës së saj.

Në disa video të publikuara më 27 mars, duken ato që shihen si forca ukrainase duke abuzuar luftëtarët e zënë rusë, të cilët kanë statusin e të burgosurve të luftës, duke përfshirë edhe të shtëna me armë zjarri ndaj tre ushtarëve në këmbë. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelenskiy, ka thënë të nesërmen se Kievi i ka parë supozimet me "shumë seriozitet" dhe do të bëjë hetime. "Nëse konfirmohen, rrahjet dhe të shtënat me armë zjarri ndaj luftëtarëve të zënë, përbëjnë krime lufte dhe Ukraina duhet të tregojë se mund dhe ka gatishmëri t'i parandalojë dhe ndëshkojë shkeljet serioze të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar", ka thënë Human Rights Watch përmes një deklaratë të lëshuar më 1 prill.

Kjo organizatë ka paralajmëruar më parë Rusinë se veprimet që ka kryer mund të konsiderohen krime lufte, duke përfshirë sulmet ajrore në teatrin e qytetit të Mariupolit.

Autoritetet ukrainase kanë thënë

se aty kanë qenë duke u strehuar civilë dhe rreth 300 prej tyre dyshohet të kenë vdekur si pasojë e sulmeve.

Gjykata Ndërkombëtare Penale ka nisur hetime për krime të mundshme të luftës që mund të jenë kryer nga të dyja palët në konfliktin në Ukrainë.

"Miratohet plani" i Kryqit të Kuq për evakuimet nga Mariupoli

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka thënë të premten, më 1 prill, se është miratuar plani i tij për evakuime nga Mariupoli nga "autoritetet e nivelit të lartë" të Ukrainës dhe Rusisë, ka raportuar agjencia e lajmeve "Reuters".

Organizata shpreson që evakuimet mund të ndodhin të premten dhe planifikon të udhëheqë 54 autobusë ukrainas dhe makina private në një konvoj jashtë qytetit të rrethuar. Mirëpo Kryqi i Kuq nuk ka siguruar leje për ndihmë humanitare dhe është nisur pa fumizime.

Zëdhënësi i Kryqit të Kuq, Ewan Watson, ka thënë para gazetarëve në Gjenevë se "përpjekjet kanë qenë dhe janë jashtëzakonisht komplekse".

A i ka thënë se "mijëra njerëz" synohet të largohen të sigurt nga qyteti.

Petro Andryushchenko, këshilltar i

kryetarit të Mariupolit, ka thënë më herët gjatë ditës se Rusia është duke bllokuar dërgimin e ndihmës në qytetin e rrethuar dhe është duke parandaluar hapjen e "korridorit humanitar" në mënyrë që banorët të ikin nga luftimet e ashpra mes forcave ukrainase dhe atyre ruse.

"Qyteti vazhdon të jetë i mbyllur dhe me dalje shumë të rrezikshme përmes transportit publik", ka thënë ai.

Qyteti i Mariupolit ka pasur një popullsi prej 430 000 banorësh para shpërthimit të luftës. Sulmet ruse në këtë qytet kanë shkatërruar një spital materniteti, qendra kulturore dhe shtëpi banimi.

NATO: Forcat ruse po rigrupohen për sulm

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se forcat ruse janë duke u rigrupuar në Ukrainë për të rritur sulmet në lindje të shtetit.

Mbretëria e Bashkuar ka thënë se Rusia është duke dërguar mes 1 200 deri në 2 000 trupa nga Gjeorgjia në Ukrainë si përforcime. Moska ka thënë të martën se do t'i zvogëlojë aktivitetet ushtarake në veri të Ukrainës dhe do të fokusohet në "çlirim" të rajonit Donbas në juglindje.

Stoltenberg ka thënë se synimi rus për të pasur rezultate ushtarake nuk ka ndryshuar ende. "Ne

shohim bombardime të vazhdueshme të qyteteve dhe ne shohim se Rusia është duke ripozicionuar disa trupa, duke i lëvizur disa, me shumë mundësi që t'i risë përpjekjet në rajonin Donbas. Në të njëjtën kohë, Rusia mban presionin mbi Kiev dhe qytete të tjera. Ne mund të presim veprime të tjera në kuadër të ofensivës", ka thënë Stoltenbergu.

Ukraina ka goditur një depo naftë në Rusi

Guvernatori rajonal Vyacheslav Gladkov ka thënë se dy helikopterë ushtarakë ukrainas kanë goditur një depo naftë më 1 prill në qytetin rus Belgorod, i cili gjendet rreth 25 kilometra në kufi me Ukrainën. Nëse konfirmohet, ky do të ishte sulmi i parë i nisur nga Ukraina në

tokën ruse, prej kur Moska ka nisur pushtimin e këtij shteti fqinj më 24 shkurt.

Gladkov ka thënë në platformën "Telegram" se helikopterët kanë goditur objektin pas kalimit të kufirit. Sipas tij, dy punëtorë janë plagosur në sulmin e supozuar. Megjithatë, kompania ruse e naftës, Rosneft, e cila ka në pronësi depon e naftës, ka thënë, në një deklaratë ndaras, se askush nuk është plagosur si pasojë e zjarrit. Në deklaratë nuk janë dhënë informacione kush e ka nisur zjarrin.

Në disa pamje, që thuhet se shpërfaqin sulmin, shihen ato që duken si raketa të cilat lëshohen para shpërthimit. Ministria ukrainase e Mbrojtjes nuk ka komentuar ende për këtë gjë.



Myftiu Tërnavë ua uron besimtarëve myslimanë Muajin e Ramazanit

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, i ka uruar të premtën të gjithë besimtarët myslimanë për Muajin e shenjtë të Ramazanit. "Përmes agjërimit besimtari mysliman synon të jetë më i devotshëm, më i përkushtuar, më i ndjeshëm, më racional, më human dhe më tolerant në raport me vetveten, familjen, komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi", ka thënë Tërnavë

në një paraqitjeje për medie. "Agjërimi e fisnikëron besimtarin, e bën më të durueshëm, më të afërt dhe më të çiltër. Gjatë këtij muaji ndër besimtarë agjërues shtohet edhe ndjenja e përkujdesjes dhe solidaritetit sepse në këtë muaj ne jemi shumë më pranë familjes, fafesisit, miqve dhe komunitetit tonë", ka thënë myftiu Tërnavë. Ai ka përmendur edhe luftën e

Rusisë në Ukrainë, duke bërë thirrje që në këtë Muaj të Ramazanit të ketë sa më shumë lutje për paqe, qetësi dhe mirëkuptim.

Muaji i Ramazanit nisi të shtunën, më 2 prill dhe do të zgjasë 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe besimtarët myslimanë përmbahen nga ngrënia dhe pirja që nga lindja e diellit deri në perëndim, në shenjë sakrifice dhe përkushtimi ndaj Zotit.



Policia gjatë vitit 2021 ka kryer 51 operacione kundër krimit të organizuar



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 PRILL - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka raportuar të premtën në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Raportimi i tij në këtë mbledhje nisi me paraqitjen e raportit të policisë për vitin 2021. Gjatë raportimit drejtori Mehmeti paraqiti në hollësi të dhëna rreth aktiviteteve përgjatë kësaj periudhe. Duke shpalosur statistikën rreth numrit të personave të përfshirë në akte kriminale, Mehmeti tha se janë kryer gjithsej 51 operacione kundër krimit të organizuar, si dhe janë konfiskuar miliona euro.

Ndërkaq, sa i përket çështjes së luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore, ai tha se janë 131 raste dhe janë arrestuar 182 persona të dyshuar.

Lidhur me luftimin e krimeve ekonomike, i pari i policisë bëri me dije se ka pasur gjithsej 339 raste, ndërkaq janë arrestuar 260 persona. Ai tregoi se janë goditur 49 grupe kriminale, ndërsa sa i përket çështjes së parandalimit të luftimit të terrorizimit, ekstremizmit dhe radikalizmit, ai tha se janë të arrestuar 14 persona. Për krim të organizuar Mehmeti sqaroi se janë realizuar 51 operacione dhe se janë iniciuar 57 raste. Në vijim ai shpalosi edhe një sërë të dhënash lidhur me angazhimet e tjera të policisë në

nivel të ngritjes së sigurisë.

Pas këtij raportimi anëtarë të komisionit kërkuan sqarime për shumë çështje, me theks të veçantë rreth procesit të testimit për rekrutimin e zyrtarëve policorë. Fillimisht kryetari i këtij komisioni, Bekë Berisha, kërkoi nga drejtori i Policisë të dhëna rreth këtij konkursi, si dhe rreth arrestimeve të fundit të zyrtarëve policorë. Berisha kërkoi sqarime edhe për këtë operacion, nëse ka pasur fakte të mjaftueshme për t'i arrestuar.

Ai, po ashtu, kërkoi përgjigje edhe rreth plaçkitjeve të fundit nëpër banka, luftën kundër kartelit të drogës, shitjet e pronave në veri dhe një sërë çështjesh të tjera. Sa i përket arrestimeve të fundit të

një numri të madh të zyrtarëve policorë, drejtori Mehmeti tha se këto hetime nuk i bënë policia, ndërkaq sqarime me të hollësishme mund të japin Inspektorati Policor i Kosovës dhe prokuroria meqë, sipas tij, ato janë kompetencë.

Sa i përket çështjes së grabitjeve nëpër banka, ai tha se shumica nga to janë zbuluar, ndërkaq për çështjen e drogës dhe narkotikëve ai tha se kjo është tejet shqetësuese dhe se vetëm për një muaj janë zbuluar 118 kg heroinë. Po ashtu, si shqetësuese ai e paraqiti edhe çështjen e drogës nëpër shkolla. Deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj, pasi foli lidhur me trafikimin në vend, tha se asnjë qeveri nuk ka ndonjë meritë për luftimin e krimit

të organizuar por kjo, sipas tij, është si rezultat i punës së policisë.

Ai në vijim kërkoi edhe të dhëna për operacionin në veri, për çështjen e targave, eprorët në pjesën e veriut, si dhe kërkoi komente nga drejtori Mehmeti lidhur me pavarësinë në aspektin operacional.

Deputeti Mefail Bajqinovci fillimisht kërkoi disa të dhëna shtesë nga drejtori i policisë, ndërsa shtoi se problemi kryesor në vend mbetet çështja e drogës. Ndërsa deputetja e LV-së, Shqipe Mehmeti-Selimi, tha se vrasja, ngacmimi, dhuna dhe droga nëpër shkolla mbeten një çështje tejet shqetësuese për të gjithë. Ajo kërkoi që të shtohet kontrolli i policisë nëpër të gjitha shkollat.

I refuzohet apeli, Kadri Veseli mbetet në paraburgim

HAGË, 1 PRILL - Paneli i Gjykatës së Apelit, më 31 mars, ka refuzuar apelin e mbrojtjes së Kadri Veselit kundër vendimit të gjykatës të procedurës paraprake për mbajtjen e mëtejme të tij në paraburgim. Kjo është bërë me dije përmes

njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Speciale.

Më 9 nëntor, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë.

Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.





FLET PËR "EPOKËN E RE", BEKIM HAXHIU

Kosova ka shënuar ngecje me qeverinë Kurti

- Qytetarët janë zhgënjyer me këtë qeveri, prandaj po ikin nga Kosova

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se gjatë qeverisjes mbi njëvjeçare të kryeministrit Albin Kurti, Kosova ka shënuar ngecje në të gjitha fushat. Haxhiu ka thënë se qytetarët janë të zhgënjyer me qeverinë Kurti. Në këtë bisedë për "Epokën e re", Haxhiu ka thënë se qeveria Kurti nuk është duke e luajtur rolin ekzekutiv, por atë të vëzhgueses. Ai ka thënë se opozita nuk ka qenë shumë aktive për faktin se kjo qeveri ka pushtet absolut. Në këtë kontekst, ai ka thënë se duhet të binden vetë qytetarët se janë mashtruar nga Kurti. Ndërsa sa i përket iniciativës për tërheqjen e 30 për qind të mjeteve nga Trusti, Haxhiu ka shprehur optimizëm se edhe deputetët e pushtetit do ta përkeqësojnë një iniciativë të tillë

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 1 PRILL - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se qytetarët e Kosovës janë të zhgënjyer me qeverinë e drejtuar nga kryeministri Albin Kurti. Në këtë bisedë për "Epokën e re", Haxhiu ka thënë se për shkak të këtij zhgënjimi qytetarët janë duke e lëshuar

Kosovën. "Qytetarët janë zhgënjyer me këtë qeveri, prandaj po ikin nga Kosova", ka thënë Haxhiu.

Haxhiu ka thënë se Kosova ka shënuar ngecje në të gjitha fushat prej që Albin Kurti është duke e udhëhequr vendin. Sipas Haxhiut, Kosova është ballafaquar me kriza të njëpasnjëshme gjatë qeverisjes Kurti. Në këtë kontekst, Haxhiu ka përmendur krizën me

energjinë elektrike, duke e akuzuar Kurtin për rritjen e çmimit të energjisë. "Një vit regres në të gjitha sferat! Një vit i krizave të njëpasnjëshme në të cilin qeveria nga institucion ekzekutiv ka pasur vetëm rol të vëzhgueses. Një dekadë nuk ka pasur shtrenjtim të rrymës, ndërsa për një vit të qeverisjes Kurti kthehen reduktimet dhe bëhet dyfishim i çmimit të rrymës. Në opozitë premtonte

lirim të energjisë elektrike, ndërsa sot e shtrenjton energjinë elektrike", ka deklaruar Haxhiu.

I pyetur në lidhje me punën e partive opozitare në raport me qeverinë Kurti, Haxhiu ka pranuar se opozita nuk ka qenë mjaft aktive. Këtë aktivitet Haxhiu e ka ndërlidhur edhe me fuqinë e numrave në Kuvendin e Kosovës. Haxhiu ka thënë se strategjia e opozitës është që qytetarët ta shohin se janë mashtruar nga Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje. "Opozita nuk ka qenë shumë aktive për faktin se kjo qeveri ka pushtetin absolut, por le të binden qytetarët se janë mashtruar nga Albin Kurti dhe fryma që ai ka ndërtuar si opozitar", është shprehur Haxhiu.

Më tutje, deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka folur edhe për

inicimin e ndryshimit të Ligjit për Trustin për t'ua mundësuar qytetarëve tërheqjen e 30 për qind të mjeteve të tyre. Ai ka thënë se mundësia e tërheqjes së mjeteve nga Trusti ka qenë kërkesë e qytetarëve të Kosovës. Në këtë kontekst, deputeti Haxhiu ka thënë se beson se kjo iniciativë e tij do të përkrahët edhe nga deputetët e shumicës parlamentare. Ai u ka bërë thirrje deputetëve të pushtetit që të votojnë pa imponime politike. "Unë kam proceduar një kërkesë të qytetarëve për mundësinë e tërheqjes së 30-përqindëshit të Trustit. Në Kuvend të gjithë jemi përfaqësues të qytetarëve dhe e kemi obligim t'i mbështesim kërkesat e tyre. Besoj shumë se deputetët e opozitës do të votojnë me integritet dhe pa imponime politike", është shprehur Haxhiu.

Një i vdekur, 26 raste të reja me Covid dhe 249 të vaksinuar

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka vdekur një person nga Covidi dhe janë raportuar 26 raste të reja me

Covid. Po kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë dhënë 249 doza të vaksinës kundër Covid. "Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet

e Kosovës janë dhënë 1 822 352 doza të vaksinës. Deri më sot 820 520 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 125 doza përforcuese dhe

doza të treta të vaksinës kundër Covid-19. Pas 752 testeve, 26 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i

vdekjes. Sot janë shënuar 40 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 223 786. Në total numri i rasteve aktive është 576", ka njoftuar MSh-ja.

Kurti kërkon hapjen e zyrës ekonomike bavareze në Prishtinë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 PRILL - Mundësitë e rritjes së bashkëpunimit, me theks në investime ekonomike dhe në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional, janë diskutuar në takim që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pasur me ministren e Shtetit për Çështje Evropiane dhe Ndërkombëtare të Bavarisë, Melanie Huml.

Kryeministri Kurti e ka falënderuar ministren Huml për

përkrahjen e vazhdueshme dhe për investimet gjermane në Kosovë. "Në Bavari jeton numër shumë i madh i mërgatës sonë dhe kjo lidhje e fortë është një shans i mirë për shtimin e investimeve të Bavarisë, por edhe të Gjermanisë në përgjithësi", ka thënë Kurti.

Si rezultat i parë i bashkëpunimit të afërt me mërgatën në Gjermani, kryeministri Kurti ka theksuar marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës

së Kosovës dhe "Besa Foundation" në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional. Kurti ka thënë se ky memorandum i mirëkuptimit do ta mbështetë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve relevantë me qëllim të lehtësimit dhe zbatimit të dialogut nacional në Republikën e Kosovës.

Modeli gjerman i sistemit dual të arsimit është treguar i suksesshëm dhe kryeministri ka kërkuar që Bavaria të ndihmojë me përvojën dhe përkrahjen në këtë fushë. "Një aspekt tjetër që do të

kontribuonte në shtimin e investimeve do të ishte edhe hapja e një zyre ekonomike bavareze në Prishtinë", është shprehur kryeministri Kurti.

Ministrja Huml e ka përgëzuar kryeministrin për të arriturat dhe progresin në Kosovë dhe ka shprehur përkrahjen dhe angazhimin e mëtejshëm të Bavarisë për një perspektivë më të qartë për rrugën e Kosovës dhe të Ballkanit Perëndimor drejt integritimit evropian dhe euroatlantik. Gjithashtu, ajo ka

përhëndetur renditjen e Kosovës përkrah botës demokratike në sanksionimin e Rusisë, pas invazionit dhe agresionit në Ukrainë, si dhe për gatishmërinë për t'i pranuar 5 000 refugjatë.

Kryeministri Kurti ka folur edhe për ndikimin rus dhe rrezikun e nxitjes së konflikteve të mundshme në vendet e Ballkanit Perëndimor. Si pasojë e këtyre zhvillimeve, ministrja Huml ka theksuar nevojën për kthimin e vëmendjes dhe riorientimin e investimeve në këtë rajon.



KFOR-i italian i dhuron MSh-së një automjet mjekësor

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka falënderuar KFOR-in italian për angazhimin për ruajtjen e paqes në Kosovë, për donacionin dhënë të premtën si dhe për kontributin e vazhdueshëm për shëndetësinë e Kosovës. "Është një ditë shumë e mirë për ne ngaqë miqtë tanë nga KFOR-i italian kanë vendosur të na dhurojnë një automjet mjekësor. Jam i nderuar ta pranoj këtë donacion të

nevojshëm që do ta modernizojë flotën e shërbimeve shëndetësore në Kosovë", ka thënë ministri Latifi. Ai e ka falënderuar edhe zëvendësambasadorin e Italisë në Kosovë, Ugo Ferrero, i cili ishte i pranishëm në këtë ceremoni, për bashkëpunimin për të shtyrë para programin e trajnimeve për profesionistët mjekësorë të Kosovës në fushën e kirurgjisë dhe kardiokirurgjisë së fëmijëve.



Një vit pa Lulëzim Krasniqin, përrurohen dy libra, njëri i tij, tjetri për të

"Epoka e re"

PRISHTINË, 1 PRILL - Të premtën është bërë një vit nga vdekja e Lulëzim Krasniqit - Arbanasit, i cili nuk ishte arritur ta fitonte betejën përballë Covid-19.

Në njëvjetorin e vdekjes së tij, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës janë përruroar dy libra që ndërlidhen me jetën dhe veprimtarin e Arbanasit.

Libri i parë i përruroar është ai me poezi, me titull "Dhe unë jam njëri", ndërsa i dyti është libër jetëshkrimor i autorit Gëzim Saraçi, me titull "Njeriu i lartësive". Redaktor i librit "Dhe unë jam njëri" është miku i Arbanasit, Gëzim Saraçi, ndërsa recensent dhe lektor profesori Bahri Koskoviku.

Recensues i librit "Njeriu i lartësive" është profesor Bedri

dhe lektori Bahri Koskoviku, i cili është mik i vjetër i Lulit, ka thënë se ky libër ngërthen në vete dashurinë, atdhedashurinë dhe padrejtësitë. "Botimi i këtyre dy librave që sot janë para jush: 'Dhe unë jam njëri' - përmbledhje me poezi dhe libri 'Njeriu i lartësive' i autorit shumë të vyer, Gëzim Saraçi, janë sendërtim i një ëndre dhe një dëshirë që ta përjetësojmë Lulin dhe ta bëjmë të përjetshëm veprën e tij", ka thënë Koskoviku, duke shtuar se mesazhi themelor në poezitë e Lulit është dashuria. Ndërsa profesor Bedri Tahiri ka thënë se libri "Njeriu i lartësive" i autorit Gëzim Saraçi është lapidar pavdekësie për njeriun e lartësive siç ishte Lulëzim Krasniqi - Arbanasi.

Profesor Tahiri ka thënë se Lulëzim Krasniqi ishte personalitet i përgatitur në shumë fusha, duke vlerësuar lart anën



Tahiri, kurse redaktor profesor Mentor Hajrizi.

Në përrurimin e këtyre dy librave kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve, miq të Lulit, familjarë dhe bashkëluftëtarë të tij.

Po në këtë ngjarje kanë marrë pjesë edhe dashamirës të librit.

Në përrurimin e këtyre dy librave janë vlerësuar lart jeta dhe vepra e Lulëzim Krasniqit - Arbanasit. Duke iu referuar librit me poezi "Dhe unë jam njëri", recensenti

intelektuale dhe njerëzore të tij.

Tahiri ka thënë se Luli ishte njeri i dashur për të gjithë dhe çdoherë ka qëndruar përballë kauzës kombëtare.

Edhe profesor Mentor Hajrizi e ka vlerësuar lart jo vetëm librin, por edhe veprimtarinë e Lulëzim Krasniqit - Arbanasit.

Më tutje, autori i librit "Njeriu i lartësive", Gëzim Saraçi, ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar dhe punuar që të botohen këto dy libra që

ndërlidhen me veprën dhe jetën e Lulëzim Krasniqit. Ai ka thënë se falë këtyre dy librave Luli do të jetojë përgjithmonë në letrat shqipe.

Kurse vëllai i Lulit, Hasim Krasniqi, i ka falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në përrurimin e këtyre dy librave. Me theks të veçantë ai ka falënderuar Gëzim Saraçin, Bedri Tahirin, Bahri Koskovikun, Mentor Hajrizin dhe Fatmir Grajçevci, të cilët janë përkujdesur që këto dy libra të dalin në dritë.

Ndërsa vajza e Lulëzim Krasniqit - Arbanasit, Elina, ka lexuar një poezi të babait të saj, me titull "Lexo dhe këputë".

Lulëzim Hysen Krasniqi ka lindur më 11 janar të vitit 1976 në fshatin Zhilivodë, komuna e Vushtrisë. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Pas

përfundimit të shkollimit të mesëm Lulëzimi ka kryer Fakultetin për Kriminalistikë. Më vonë ka kryer studimet edhe në programin master: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci.

Lulëzim Krasniqi ishte ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në fshatin Zhilivodë dhe ishte ndër të parët që mori rrugën për furnizim me armë në Shqipëri. Pas përfundimit të luftës ai kishte punuar arsimtar i gjuhës angleze në shkollën "Liria" në Stroc, ndërsa nga viti 2004 ka punuar në Policinë e Kosovës. Lulëzimi ka punuar në detyra të ndryshme në Policinë e Kosovës, kryesisht në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë. Krahas punës që bënte si zyrtar policor, Lulëzimi merrej edhe me shkrime shkencore të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare, pasi ishte njohës i thellë i asaj fushe dhe kishte

përfunduar studimet me rezultate maksimale. Gjithashtu, ai merrej edhe me analiza politike të situatës në vend. Lulëzimi merrej edhe me poezi, në të cilat vërehet qartë çiltërsia e tij dhe mënyra e veçantë se si ai e perceptonte dashurinë, se si i thurte vargjet për dashurinë. Për dashurinë e tij të dytë, natyrën, ai çdoherë u bënte thirrje njerëzve që sa më shumë ta duan natyrën, t'i duan alpet e bukura shqiptare. Pothuajse çdo fundjavë, nga majat më të larta të bjeshkëve shqiptare, thërriste njerëzit ta duan natyrën dhe t'i duan alpet e bukura shqiptare.

Lulëzim Krasniqi ka lënë në dorëshkrim një libër shkencor të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe dy libra me poezi.

Lulëzimi ka ndërruar jetë nga Covidi më 1 prill të vitit 2021, duke lënë pas vetes bashkëshorten dhe tri vajza.



FSK-ja merr pjesë në ushtrimin "Defender Europe 23"

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Në Bosnjë Hercegovinë është duke u realizuar Konferenca Fillestare Planifikuese për Stërvitjen e shkallës së gjerë të drejtuar nga Komanda e Ushtrisë së ShBA-së për Evropë (EUCOM) dhe Ushtria e ShBA-së për Evropë e Afrikë (USAEUR-AF) "Defender - Europe' 23", që do të zhvillohet

gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 2023 në regionin e Ballkanit dhe Detit të Zi. Në këtë konferencë vendi ynë paraqitet nga shefi i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve të ShP të FSK-së, kolonel Ejup Maqedonci, dhe shefi i Operacioneve të Regjimentit të Parë të Këmbësisë, major

Gëzim Osmani. Në këtë konferencë po marrin pjesë rreth 300 ushtarakë nga 28 vende të NATO-s dhe vendeve partnere. Republika e Kosovës do të jetë ndër vendet pritëse të kësaj stërvitjeje të madhe dhe Forca e Sigurisë së Kosovës do të marrë pjesë me një numër të madh të personelit dhe njësisive.



Ministri Latifi: Vaksini, mënyra më efektive për parandalimin e Covidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PEJË, 1 PRILL - Për më shumë se një vit vaksinimi kundër Covid-19 ka qenë prioriteti numër një në botë në ballafaqimin me Covid-19 dhe, gjithashtu, edhe në Kosovë. Kështu ka thënë të premtën ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, në ceremoninë e ndarjes së mirënjohjeve për ekipet e vaksinimit në komunën e Pejës, të cilat ekepe i ka falënderuar për punën në vaksinimin e popullatës. "Të jesh në krye dhe pjesë e këtij procesi jetik për shëndetin

publik të popullatës është sa përgjegjësi, aq edhe motiv dhe privilegj për t'i shërbyer popullatës në ditë shumë të vështira", ka thënë ai, duke theksuar se përderisa klinikistët janë heronjtë tanë në trajtimin e të prekurve me Covid-19, ekipet e vaksinimit janë heronjtë e parandalimit të shumë vdekjeve nga Covid-19 në Kosovë përmes vaksinimit. Ministri Latifi ka thënë se vaksinimi mbetet mënyra më e thjeshtë dhe më efektive për parandalimin e formave të rënda të sëmundjes nga Covid-19. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë të

vaksinohen, sepse pandemia nuk ka përfunduar ende, ndërsa në vende të ndryshme të botës është duke u përhapur nënvarianti BA 2 i Omicronit, që e bën vaksinimin të domosdoshëm. Drejtoresha e QKMF-së në Pejë, Myrvete Salihu, ka falënderuar ministrin Latifi për bashkëpunimin, kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme që ka treguar në këtë proces. Po ashtu, e ka falënderuar edhe Ministrinë e Shëndetësisë për mbështetjen e vazhdueshme të procesit të vaksinimit kundër Covid-19 me staf mbështetës.



Osmani dhe Konjufca nderojnë të rënë në masakrën e Lybeniqit



PEJË, 1 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, së bashku me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, e shoqëruar nga kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, të premtën kanë bërë homazhe në 23-vjetorin e rënies së dëshmorëve dhe martirëve në Lybeniq të Pejës. Presidentja Osmani ka thënë se sakrificat e martirëve dhe dëshmorëve të Lybeniqit ka bërë që ne sot ta gëzojmë aspiratën tonë shekullore për liri. "Këtyre njerëzve që kanë dhënë gjithçka deri në më të shtrenjtën e tyre, pra jetën e tyre, u kemi borxh gjithçka sepse asnjëherë ne nuk do të mund ta shijonim lirinë, asnjëherë nuk do të mund ta arrinim pavarësinë në qoftë se ata nuk do ta jepnin jetën për të", ka thënë presidentja Osmani, duke shtuar se sot ka takuar shumë familjarë që kanë humbur më të dashurit e tyre, e disa e kanë

humbur gjithë familjen. "U kemi borxh për tërë jetën, në të njëjtën kohë është obligim yni institucional që asnjëherë mos t'i ndalim përpjekjet tona për drejtësi. Në këtë masakër, sikurse edhe në çdo tjetër që regjimi gjenocidal i Serbisë ka kryer ndaj popullatës së pafajshme civile në Kosovë, por edhe gjithë dëshmorët që kanë rënë, dëshmojnë se sa barbare ka qenë lufta e shtetit serb ndaj popullit të Kosovës", ka thënë Osmani. Ajo ka theksuar se masakra e Lybeniqit është dëshmi e qartë e qëllimit shfarosës që regjimi i Millosheviqit që kishte ndaj popullit të Kosovës. "Nuk duhet të ndalemi ditë pas dite dhe të punojmë pareshtur të gjithë bashkërisht, pa dallim, në mënyrë që gjaku i tyre mos të shkojë huq dhe në mënyrë që kryerësit e këtyre veprave makabre, kryerësit e gjenocidit, të dalin para drejtësisë", ka thënë Osmani.

Aksidentet në komunikacion, 26 persona kërkuar ndihmë mjekësore në 24 orët e fundit

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Si pasojë e lëndimeve të marra në aksidente trafiku, 26 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën e Klinikës Universitare të Kosovës në Prishtinë gjatë 24 orëve të

fundit. Përveç tyre, për shkak të problemeve të ndryshme shëndetësore, në këtë klinikë kanë marrë tretman edhe 240 persona të tjerë, sipas raportit të punës. Prej këtyre, 66 pacientë janë trajtuar në Dhomën e

Reanimimit (Dhoma e Kujdesit të Avancuar Emergjent), 49 pacientë janë regjistruar si raste kirurgjike, 68 janë mjekuar në Dhomën e Shërbimit Internistik dhe 61 në Dhomën e Shërbimit Ortopedik.



Qeveria hesht lidhur me strategjinë për energji

PRISHTINË, 1 PRILL - Edhe pse termocentralet e Kosovës janë në mesin e ndotësve më të mëdhenj në Evropë, Kosova ende nuk ka afate të qarta për zvogëlimin apo braktisjen e prodhimit të energjisë elektrike përmes djegies së thëngjillit.

Kosova sasinë më të madhe të energjisë elektrike e prodhon nga djegia e thëngjillit në termocentralet e Obiliqit. Kjo lëndë konsiderohet si një nga ndotëset më të mëdha të ajrit dhe shumë vende në Evropë janë duke krijuar strategji për të hequr dorë prej saj.

Qeveria e Kosovës më 18 nëntor të vitit 2021 ka prezantuar grupin punues për hartimin e një strategjie të ngjashme. Atëbotë është thënë se Strategjia Kombëtare e Energjisë 2022-2031 "do të sigurojë një tranzicion energjetik, që për vizion ka dekarbonizimin deri në vitin 2050".

Në Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës nuk u janë përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se kur do të përfundojë hartimi i strategjisë dhe nëse ky dokument do të vendosë një datë të saktë se kur do të përfundojë procesi i dekarbonizimit, apo mbylles së termocentraleve me thëngjill.

Sipas organizatës mjedisore "Bankwatch Network", me seli në Pragë të Çekisë, Kosova - për nga niveli i ndotjes që prodhojnë vendet e Ballkanit Perëndimor - renditet e treta, pas Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. "Serbia, duke emetuar sasinë më të madhe të ndotësve të ajrit në sasi absolute, ka pjesën më të madhe të prodhimit të ndotjes (44 për qind), e ndjekur nga Bosnjë Hercegovina me 23 për qind, Kosova me 18 për qind, Maqedonia e Veriut me 11 për qind dhe Mali i Zi me 5 për qind", thuhet në një raport të kësaj organizate, të publikuar në fillim të këtij viti. Shqipëria nuk shkakton fare ndotje gjatë prodhimit të energjisë pasi nuk ka asnjë termocentral.

Sipas "Bankwatch Network", Kosova prin me sasinë e prodhuar të pluhurit dhe të oksideve të azotit (NOx), që e lëshojnë termocentralet.



Pippa Gallop, këshilltare për energjinë për Evropën Juglindore, në këtë organizatë thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova është vonuar sa i takon përcaktimit të kohës se kur do të jetë në gjendje të heqë dorë nga thëngjilli për prodhim të energjisë. "Fakti që Strategjia e re e Energjisë [e Kosovës] nuk është ende gati, nuk është shenjë e mirë. Çështja është se ato termocentralet janë aty dhe ndoshta ato do të jenë në gjendje të punojnë edhe për disa vjet. Nga këndvështrimi i politikave do të ishte në rregull nëse Kosova do të largohej nga thëngjilli deri më 2030 - 2035, pra t'i mbyllë ato termocentralet ekzistuese", vlerëson Gallop.

Ajo thotë se nuk beson që termocentralet e Kosovës do të jenë në gjendje të prodhojnë energji pas vitit 2035 për shkak të vjetërsisë. "Ato termocentralet të Kosovës janë, vërtet, të vjetra dhe kapacitetet e reja solare dhe të erës duhet të vendosen sa më parë", thotë Gallop.

Pavarësisht prej disa investimeve në burime alternative të energjisë së ripërtërishme, rreth 95 për qind e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga djegia e thëngjillit, 2.7 për qind nga hidrocentralet, si

dhe 2.3 për qind nga era dhe panelet solare.

Kriza energjetike ia hapi sytë Kosovës

Më 22 dhjetor të vitit të kaluar në Kosovë kanë filluar shkurimet e energjisë elektrike si pasojë e një krize globale energjetike. E gjendur në këtë situatë, Qeveria e Kosovës ka njoftuar se do të fokusohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja për energji të ripërtërishme, përfshirë atë solare dhe të erës.

Më 11 mars është vënë në funksion parku i prodhimit të energjisë nga era, i cili ndodhet në fshatrat Bajgorë dhe Selac të Mitrovicës së Jugut.

Ky park i erës, që përfshin 27 turbina, mbulon 10 për qind të kapacitetit prodhues që ka Kosova. Më 24 mars Qeveria e Kosovës i ka dhënë dritën jeshile edhe ndërtimit të një projekti solar në vlerë prej 64 milionë eurosh në komunën e Obiliqit.

Sipas Qeverisë së Kosovës, ky projekt, mes të tjerash, nënkupton: shkurtrim të dyoksidit të karbonit për 40 mijë tonë në vit; shkurtrim të kërkesës për energji

elektrike për qëllime të ngrohjes dhe kyçje në rrjetin e ngrohjes për 12 mijë familje apo 60 mijë banorë.

Syla: Kriza nuk duhet ta pengojë Kosovën që të punojë drejt dekarbonizimit

Lulëzim Syla, njohës i fushës së energjisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kriza globale energjetike dhe pushtimi rus i Ukrainës e bëjnë të paparashikueshëm normalizimin

e situatës energjetike.

Kriza botërore energjetike është theksuar sidomos në pjesën e dytë të vitit 2021, kur bizneset u janë rikthyer aktiviteteve të cilat janë pezulluar gjatë pandemisë Covid-19.

Kriza është thelluar tutje nga 24 shkurti, kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës. Rusia është në mesin e furnizuesve kryesorë të Evropës me gaz dhe lufta ka shkakuar lëkundje në tregje. Por, kjo krizë nuk duhet ta pengojë Kosovën që të punojë në drejtim të nxitjes së investimeve në burime të ripërtërishme, thotë Syla. "Qeveria, edhe në kuadër të strategjisë, por edhe të mekanizmave të tjerë, duhet të veprojë më shpejt për gjetjen e alternativave për mbështetje të qytetarëve dhe bizneseve në fushën e eficiencës së energjisë - si potencial shumë i madh për kursim të energjisë, por duhet të nxisë edhe investime në burime të ripërtërishme", thotë Syla.

Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë është i lartë për shkak se shumë amvisëri ngrohen me rrymë, duke përdorur pajisje joeficiente, pra të tilla që shpenzojnë shumë energji elektrike.

Pajisjet eficiente në treg kanë një çmim më të lartë sesa pajisjet e thjeshta.

Kosova aktualisht ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavatë energji elektrike në ditë, kurse konsumi në kohën e dimrit arrin deri në 26 mijë megavatë në ditë. Këtë diferencë Kosova zakonisht e importon.

Kur do të largohet rajoni nga thëngjilli?

Vendet e BE-së kanë vendosur afate specifike se kur do ta ndalojnë përdorimin e thëngjillit për prodhimin e energjisë elektrike. Por, një gjë të tillë kanë ngecur ta bëjnë shumë vende të Ballkanit Perëndimor, thuhet në një publikim të organizatës evropiane të mjedisit, Europe Beyond Coal.

Kosova është zotuar se do të heqë dorë nga thëngjilli deri në vitin 2050, Mali i Zi deri në vitin 2035, ndërsa Maqedonia e Veriut është zotuar se do t'i mbyllë termocentralet më së largu deri në vitin 2027. Serbia dhe Bosnjë Hercegovina nuk kanë caktuar ende ndonjë datë.

Shtyhen afatet për obligimet e tatimit në pronë dhe deklarimit të të ardhurave personale

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar qytetarët se ka marrë vendim lidhur me zgjatjen e afateve për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë, si dhe deklarimit të të ardhurave personale.

Bazuar në vendimin e ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve afati për paraqitjen e ankesave ndaj faturës së

tatimit në pronë zgjatet deri më 31 maj 2022, kurse afati për pagimin e kështit të parë të tatimit në pronë zgjatet deri më 30 qershor 2022. "Në anën tjetër, duke konsideruar rëndësinë e deklarimit të të ardhurave personale dhe informimit sa më të drejtë të qytetarëve lidhur me deklarim e të hyrave shtesë, bazuar në po të njëjtin vendim, është zgatur afati për

deklarimin e të ardhurave personale deri më datë 31 maj 2022. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet e përkushtuar për rritjen e efikasitetit të mbledhjes së taksave, ashtu që të mund të zbatohen politikat zhvillimore të programit qeverisës 2021-2025", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



Pse rrënja e çdo rezistence është Eksodi i Moisiut



Një ngjarje që kaloi pothuajse pa u vënë re ishte vendimi i orkestrës dhe korit të Odessa-s për të kënduar në shesh “Va’ Pensiero” të Nabucco, të Verdit. Mesazhi ishte shumë i qartë: kori nostalgjik i të internuarve dhe skllëvërve hebrej në Babiloni i referohej luftës së italianëve kundër forcës pushtuese austriake, ndërsa objektivi ishte qartësisht agresori rus. Pse të merrni frymëzim nga Eksodi dhe të shkoni kaq larg në histori për të shprehur dëshirën tuaj për liri? Michael Walzer në esenë e tij “Eksodi dhe revolucionin”, shkruan se historia e çlirimit të popullit hebre nga Egjipti është bërë paradigma e çdo revolucionit: revolucionin i Spartakut dhe ai i skllëvërve zezakë në SHBA që transformuan vendin (e famshme kënga “Go Down Moses”, e krijuar saktësisht atëherë).

Mund të jetë interesante të krahasohet me atë që u përpoq të bënte në 1825, Car Nikolla I, i cili –

nga frika se revolta e Dhjetorit që ai shtypi mund të merrej si model – u përpoq më kot të fshinte kujtesën e saj nga librat: mbi këtë histori Lev Tolstoy u frymëzua për romanin “Ringjallja”.

Historia e treguar në Bibël i përket gjithë botës perëndimore dhe është bërë referencë për luftën për lirinë nga vuajtjet dhe shtypja: edhe gjuha e përdorur dhe fazat e luftës për çlirim shprehen me të njëjtat fjalë të përdorura nga Bibla: ikja nga Egjipti, besëlidhja e Sinait për të marrë urdhëresat, udhëtimi në shkretëtirë për të mbërritur më në fund në tokën e premtuar. Nëse kjo histori nuk do të ishte transmetuar me shkrim dhe gojarisht, ajo nuk do të ishte një frymëzim për shoqërinë perëndimore sot: hebrejntë e kujtojnë këtë ngjarje me festën e Pashkëve: protagonistët e ceremonisë që shoqëron darkën e Pashkëve janë fëmijët, të cilëve u është besuar detyra për të përcjellë mesazhin e lirisë tek

brezat e ardhshëm.

Ky është mesazhi që Bibla dëshiron të na përcjellë duke treguar këtë histori: një popull nuk ekziston nëse nuk është në gjendje të ushtrojë lirisht rolin e tij në histori. Kur është e nevojshme, ne duhet të luftojmë për liri dhe të investojmë të gjitha burimet e nevojshme (edhe armë nëse nuk ka zgjidhje tjetër).

Faraoni egjiptian ishte në krye të fuqisë më të madhe të kohës, e cila ishte fajtorë për tentativën e gjenocidit ndaj të gjithë fëmijëve hebrej: në procesin e çlirimit, Moisiu provoi disa herë rrugën e dialogut dhe vetëm pas refuzimeve të vazhdueshme për të pranuar një kompromis, kriza i bëri hebrejntë të iknin dhe “mbyti” Egjipti. Për t’i dhënë kuptim çlirimit nga Egjipti, operacioni duhej të përfundonte: ishte e nevojshme që popullsia e skllëvërve të piqej dhe të bëhej vërtet e lirë dhe të merrte një ligj që rregullonte ekzistencën e tyre.

Ky proces zgjati dyzet vjet, deri në zhdukjen e brezit që kishte vuajtur nga skllavëria dhe që mbante mbi vete plagët e skllavërisë: më tej përgatitja dhe një marshim i gjatë në shkretëtirë, në tokë të askujt dhe të gjithëve, ku të mund të formohej karakteri i një kombi të ri, duke i dhënë atij një ligj dhe vlera mbi të cilat bazohet identiteti.

Një person ose një komunitet që sulmohet ka për detyrë të mbrohet me armët që disponon dhe me të gjitha ato që mund të marrë. Megjithatë, rezistenca hebreje nuk u kufizua kurrë vetëm në përdorimin e armëve. Rreziku është të bësh luftën qendër mbi të cilën vendoset identiteti dhe jo të kesh një projekt alternativ.

Prandaj, ata që kërkojnë të mos investojnë në armë, duhet të kenë forcë të kërkojnë investime proporcionale në fushën e arsimit dhe kulturës me projekte të besueshme. Kushdo që merret

me fushën e kulturës e di se kultura është finalja e të gjitha investimeve. Edhe investimet në armë nuk do të jenë të dobishme nëse nuk shoqërohen me një propozim që përfshin ndërhyrje të reja në fushën e arsimit, kulturës dhe universiteteve. Pësach është festa e çlirimit, e cila manifestohet si festë e lirisë: fjala Pësach (Pashkë) e ndarë në dy pjesë – Pè dhe Sach – do të thotë goja që flet. Moisiu ishte në gjendje të shpallte para faraonit të drejtën e “skllëvërve” për të folur lirshëm përpara mbretit egjiptian. Sipas rrëfimit biblik, përdorimi i fjalës e karakterizon njeriun në lidhje me qeniet e tjera dhe është shprehje e urtësisë hyjnore: ajo është e shenjtë dhe duhet përdorur me mençuri. Prandaj, ne e kuptojmë pse, siç argumenton Walzer, Eksodi me të gjitha mesazhet e tij është rrënja dhe paradigma e çdo lëvizjeje revolucionare. / *La Repubblica* – *Bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Dukagjini ndahet baras me Malishevën, sot derbi Prishtina - Llapi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 1 PRILL - Superliga e Kosovës në futboll është rikthyer të premtën me ndeshjen hapësë të javës së 27-të në mes të Dukagjinit dhe Malishevës, e cila ka përfunduar me rezultat 0-0. Pavarësisht prej angazhimit të të dyja skuadrave, gola nuk pati përgjatë 90 minutave dhe skuadrat ndanë pikët. Dukagjinit nuk i ka konvencuar aspak ky barazim, pasi vazhdon të jetë në pozitën e tetë me 30 pikë të grumbulluara, ndërsa Malisheva është paksa më e qetë dhe ka 34 pikë dhe zë



vendin e pestë. Sot (e shtunë) zhvillohet derbi në mes të Prishtinës dhe Llapit. Kryeqytetasit nuk janë në formë të mirë në këtë

edicion dhe aktualisht renditen në pozitën e gjashtë me 32 pikë. Në anën tjetër, Llapi është në pozitën e katërt me 41 pikë dhe do të

përpiqet ta marrë maksimumin nga kjo ndeshje. Sot zhvillohet edhe ndeshja në mes të Ulpianës dhe Dritës. Vendasit janë në garë për mbijetesë dhe synojnë të nxjerrin rezultat të favorshëm nga kjo ndeshje, në anën tjetër Drita po lufton për titull dhe nga kjo ndeshje pret tri pikë të plota. Të dielën do të zhvillohet ndeshja kryesore e kësaj xhiroje. Do të takohen Gjilani dhe Ballkani. Ismet Munishi me Gjilanin do të përpiqet të arrijë fitore për ta ngushtuar diferencën e pikëve, kurse suharekasit mund të jenë të kënaqur edhe me një pikë për faktin se do t'i mbante në vendin e

parë. Ndeshja e pestë është ajo në mes të Drenicës dhe Feronikelit. Kuqezinjtë janë favoritë absolutë në këtë ndeshje ndaj rivalëve të "Nikelit" që, thajse, janë pajtuar me rënien nga Superliga.

SUPERLIGA - Java 27

Dukagjini - Malisheva 0-0

Të shtunën takohen:
13:00 Prishtina - Llapi
13:00 Ulpiana - Drita

Të dielën takohen:
13:30 Gjilani - Ballkani
14:00 Drenica - Feronikeli

Bashkimi dhe Prishtina duan finalen, Penza dhe Trepça për barazim

Në fundjavë do të zhvillohen ndeshjet e dyta gjysmëfinale të "play-off"-it në Superligën e femrave. Takimi i parë zhvillohet sot (e shtunë) ndërmjet Bashkimit dhe Penzës. Prizrenaset fituan takimin e parë në Pejë me shifrat 61:76 dhe në rast të fitores do të kualifikohen në finale, ndërsa kampionet e Kosovës duan ta mbrojnë titullin dhe duhet patjetër të fitojnë në mënyrë që finalistët të përcaktohet në përballjen

e tretë mes këtyre dy skuadrave. Vashat prizrenase, pasi fituan Kupën, e duan edhe një trofe, ndërkohë që ato pejane duan finalen dhe të fitojnë titullin. Përballja e dytë gjysmëfinale zhvillohet të dielën në mes të Trepçës dhe Prishtinës. Skuadra prishtinase fitoi takimin e parë në kryeqytet me rezultat 76:64 dhe është favorite për të depërtuar në finale, pasi në elitën e basketbollit në garat e

rregullta kishte 20 fitore në po aq ndeshje, duke mos pësuar asnjë humbje, ndërkohë që mitrovicaset shpresojnë në fitore për t'u vendosur finalistë në takimin e tretë.

GJYSMËFINALET E DYTA

Të shtunën takohen:
20:00 Bashkimi - Penza

Të dielën takohen:
13:00 Trepça - Prishtina



Marku: E respektoj rivalin, por në ring fitoj unë



NEWCASTLE, 1 PRILL - Në Newcastle sot (e shtunë) do të zhvillohet dueli i boksit në mes të shqiptarit Florian Marku dhe britanikut Chris Jenkins. Një sfidë ku Marku (10 fitore, 1 barazim) do ta mbrojë titullin kampion bote në kategorinë IBF International, pesha "welter". Boksierët kanë zhvilluar konferencën për shtyp, ku

kanë shpalosur objektivat e tyre. Natyrisht që të dy synojnë fitoren, por boksieri shqiptar, i pamposhtur në ring, synon të qëndrojë i tillë edhe pas kësaj sfide. "E respektoj Chris, por në ring do të jetë ndryshe. Aty ka sfidë dhe duelin do ta fitoj unë për ta mbrojtur titullin. Jam përgatitur fort dhe jam në formë të mirë sportive", u

shpreh Florian Marku, që mbante edhe gjerdanin e kampionit me vete. Boksierët kanë kryer peshimet zyrtare dhe më pas do t'i kryejnë përgatitjet e fundit për duelin. Chris Jenkins është një veteran i ringut, me 22 fitore, 4 humbje e 3 barazime. "Dua ta shoh flamurin kuqezi të valëvitit mes fansave", ka shtuar Marku.

Kosova e treta në ranglistën botërore në paraglajdzëm

PRISHTINË, 1 PRILL - Në mesin e 71 shteteve garuese anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Aeronautikës, shteti i Kosovës ka arritur të renditet në vendin e tretë. Vendi i tretë në botë u arrit falë disiplinës së jashtëzakonshme dhe punës së

palodhshme të sportistëve të Federatës Aeronautike të Kosovës. Përkrahja nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës ka mundësuar pjesëmarrjen e sportistëve të Federatës Aeronautike të Kosovës në gara ndërkombëtare, në

të cilat asnjëherë nuk munguan rezultatet kulminante nga këta sportistë. Sportistët nga Kosova këtë vit do të marrin pjesë në më shumë se 15 gara ndërkombëtare dhe padyshim pritet të arrijnë rezultate të tjera të larta në këtë sport.



Ademi, pjesë e ekipit të UEFA-s

Prishtinë, 1 prill - Në kuadër të zhvillimit të Kongresit të FIFA-s në Doha të Katarit është organizuar edhe turneu në futboll, ku kanë marrë pjesë 10 ekipe: FIFA, UEFA, OFC, AFC,

CONCACAF, CONMEBOL, CAF, sponsorët, transmetuesit e eventeve të FIFA-s dhe mediet. Në ekipin e UEFA-s, krahas shumë emrave të njohur të futbollit si Figo, Boban e

Maxuell ishin edhe presidenti i UEFA-s, Aleksandër Çeferin dhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi. Ekipi i UEFA-s arriti deri në çerekfinale, derisa presidenti Ademi luajti në të

gjitha ndeshjet. Ky respekt dhe vlerësim që i është bërë kreut të FFK-së dëshmon edhe një herë raportet tejet të mira dhe miqësore që ai i ka krijuar me drejtuesit e UEFA-s.



Adriatik Rraci, menaxher i përfaqësueseve të Kosovës

PRISHTINË, 1 PRILL - Adriatik Rraci është emëruar menaxher i përfaqësueseve të Kosovës në Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK). Rraci për pesë vjet ka qenë në klubin e Pejës, nga viti 2016 deri më 2021, duke qenë menaxher i klubit, ndërsa në dy vjetët e fundit ka qenë edhe drejtor sportiv në klubin pejan. Adriatiku ka qenë basketbollist i klubit verdhezi, nga grupmoshat e reja deri në ekipin e parë. Ai është shprehur i kënaqur që do të jetë pjesë e përfaqësueseve të Kosovës. "Jam i lumtur me pritjen që më është bërë në FBK dhe mezi po pres ta filloj punën. Jam i motivuar për të punuar me përfaqësueset e Kosovës dhe shpresoj se do të kemi suksese së bashku", është shprehur Rraci për faqen zyrtare të FBK-së.

Sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka shtuar që Rraci do të jetë një ndihmë e madhe për Federatën e



Basketbollit dhe përfaqësueset e Kosovës. "Jam e lumtur që Adriatik Rraci i është bashkuar Federatës së Basketbollit të Kosovës. Përvojën e tij disavjeçare do ta bartë edhe në përfaqësueset e Kosovës dhe të

kontribuoj në realizimin e programeve të FBK-së. Ne zhvillojmë shumë aktivitete dhe gara ndërkombëtare me përfaqësueset e Kosovës, andaj shpresoj që do të kemi suksese së bashku", ka deklaruar Dushku.

Milwaukee mposhti Brooklynin, humbasin lakersat dhe clippersat

BROOKLYN, 1 PRILL - Skuadra kampione e Milwaukee Bucksit fitoi me rezultat 120-119 ndaj Brooklynit pas kohës shtesë, në një ndeshje spektakolare mes dy ekipeve pretendente për titull këtë sezon në NBA. Për Bucksin u dallua Antetokounmpo, me 44 pikë e 14 rebounde. Ai bëhet shënuesi më i mirë në historinë e Milwaukeees. Pas kohës shtesë fiton edhe Chicago, që mundi me rezultat 135-130 Clippersin, ndeshje ku u dallua DeRozani me 50 pikë. Zhgënjëjnë edhe



lakersat, tashmë jashtë edhe zonës "play-in". Kalifornianët (pa LeBron dhe Davis në fushë) u

mundën 122-109 nga Utah Jazzi (Mitchell 29 pikë dhe Gobert 25 pikë).

REZULTATET

Detroit - Philadelphia	102-94
Atlanta - Cleveland	131-107
Brooklyn - Milwaukee	119-120
Chicago - Clippers	135-130
Utah Jazz - Lakers	122-109

SHKURT

Unitedi e dëshiron Rrahmanin

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës, Amir Rrahmani, po kalon çastet më të mira në karrierë si me fanellën e "dardanëve", po ashtu edhe me skuadrën e Napoli.

28-vjeçari ka tërhequr interesimin e shumë klubeve evropiane, përfshirë Manchester Unitedin. Unitedi është i interesuar për një qendërmbrojtës stabil pasi po ka probleme në atë repart. Ish-futbollisti i Dinamo Zagrebit dhe Veronës me karakteristikat e tij do të ishte ideal për ekipin nga "Old Trafford". Edhe pse vetë Rrahmani ditë më parë tha se është i lumtur në Napoli, ku e sheh veten më gjatë, futbollit nuk i dihet kurrë.

Trajneri i Torinos: Berisha është titullar

Torino rikthehet të luajë Salerno, ku kërkon ta bëjë kthesën në kampionat. Skuadra në portë edhe në këtë duel pritet ta ketë Etrit Berishën, teksa konfirmimi ka ardhur edhe nga trajneri Juriq. "Pushimi ka shërbyer për të reflektuar. Ka pasur problematika, por në këto tetë ndeshje kemi goditur 6 herë shtyllën, kemi pësuar 4 gabime të gjyqtarëve dhe kemi pësuar 3 gola në minutat e fundit. Kemi shumë për të përmirësuar, por ndonjëherë futbollit është kështu. Berisha është paraqitur mirë në dy ndeshje dhe më pas ndodhi një gabim ose jo gabim me Genoan. Por ai ka luajtur shumë mirë kundër Interit dhe Bolognas: synimi im është të vazhdoj të jetë titullar", ka thënë Juriq.

Newcastle interesohet për Coutinhon

Newcastle Unitedi është i vendosur të nënshkruajë me yllin brazilian të Aston Villas, Philippe Coutinho. Në bazë të asaj që raporton Sport, ideja e kërreëve të Newcastle është që ish-lojtarin e Liverpoolit ta marrin si transfer permanent. Coutinho u transferua tek Aston Villa gjatë janarit si huazim me të drejtë blerje. Gjatë këtij sezoni me shtatë herë kampionët e Anglisë, Coutinho ka shënuar katër gola dhe ka asistuar tri herë.

Dybala, oferta me bollëk

Jo vetëm Interi dhe disa ekipe në Spanjë, por nga Anglia ka ardhur oferta e parë për Paulo Dybalan. Sulmuesi në largim nga Juventus është kontaktuar nga Arsenali, skuadër e cila është gati ta vërë argjentinasi në qendër të projektit të tij, me trajnerin Mikel Arteta që i adhuron lojtarët si Dybala, duke u nisur edhe nga ideja e futbollit të tij teknik e sulmues. Në të njëjtën kohë, "topçinjtë" i kanë garantuar 10 milionë euro neto në sezon numrit 10 bardhezi.

Fernandesin rinovon kontratën me Unitedin: Një ëndërr e bërë realitet

Bruno Fernandes tashmë zyrtarisht ka nënshkruar kontratën e re me skuadrën e Manchester Unitedit. Fernandezi ka rinovuar kontratën me Unitedin deri në vitin 2026, me opsion zgjatjen edhe për një vit tjetër.

Falë impaktit që ka pasur të "Djajtë e Kuq", portugezit i është dyfishuar paga, pra do të përfitojë 240 mijë sterlina në javë. Fernandesin ka shënuar 49 gola dhe ka dhënë 39 asistime në 117 paraqitje me skuadrën angleze. Lojtar

portugez ka thënë edhe fjalët e para pas këtij rinovimi, teksa shprehet shumë i lumtur pasi ëndrra e tij tashmë është bërë realitet. "Që nga momenti kur u bashkova me Manchester Unitedin kam pasur një marrëdhënie të veçantë me

klubin dhe tifozët tanë të mrekullueshëm. Jam rritur duke parë këtë skuadër, duke ëndërruar të kem mundësinë të luaj këtu një ditë. Ajo ëndërr tani është një realitet dhe një nder. Edhe pas dy vjetësh është ende e mahnitshme të

dalësh në 'Old Trafford', t'i dëgjosh tifozët të këndojnë për ty dhe të shënosh. Është privilegj i vërtetë të veshësh këtë fanellë dhe të luftosh për këtë klub të jashtëzakonshëm", ka deklaruar Fernandesin.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "EnvriCon" Sh.p.k. Uglarë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mbledhjen, grumbullimin, maganizimin e mbeturinave metalike, vajrave mbeturinë, akumulatorëve, impianti për trajtimin e djegies së mbeturinave spitalore, medicinale, shtazore dhe organike të përgjithshme, impianti për trajtimin sterilizimin e mbeturinave në Harilaq komuna e Fushë Kosovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.04.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Holiday Resort"-sallën e takimeve në fshatin Sllatinë, Fushë Kosovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "EnvriCon" Sh.p.k. Uglarë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mbledhjen, grumbullimin, maganizimin e mbeturinave metalike, vajrave mbeturinë, akumulatorëve, impianti për trajtimin e djegies së mbeturinave spitalore, medicinale, shtazore dhe organike të përgjithshme, impianti për trajtimin sterilizimin e mbeturinave në Harilaq komuna e Fushë Kosovës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "EnvriCon" Sh.p.k. Uglarë, Graçanicë për mbledhjen, grumbullimin, maganizimin e mbeturinave metalike, vajrave mbeturinë, akumulatorëve, impianti për trajtimin e djegies së mbeturinave spitalore, medicinale, shtazore dhe organike të përgjithshme, impianti për trajtimin sterilizimin e mbeturinave në Harilaq komuna e Fushë Kosovës.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit nr.08 të datës 28.03.2022, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 01.04.2022 të shpallë;

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

Një(1) Zyrtar/e Administrativ/e – Asistent/e në Njësinë punuese në Mitrovicë

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Kryen të gjitha punët e asistentit të cilat i përcakton Menaxheri i Njësisë ;
- Mban evidencën zyrtare të thirrjeve telefonike dhe takimeve;
- Pranon thirrjet dhe shkresat, kryen punët kompjuterike nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës;
- Punë tjera teknike që i cakton Menaxheri i Njësisë, siq janë shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve, arkivimi i dokumenteve dhe të postës për dorzim intern dhe ekstern, i të njejtave;
- Nëse është nevoja edhe qëndriminë më të gjatë se orari i rregullt i punës në raste të veçanta;
- Si dhe punë tjera të kësaj natyre, të cilat i përcakton sipas urdhërësës së eprorit të drejtpërdrejtë;
- Për punën që kryen i përgjigjet Menaxherit të Njësisë.

Kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:

- Të ketë Diplomë Universitare;
- CV-në
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj.mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 01.04.2022 deri më datën 17.04.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Jeton Bytyqi shpallë të pavlefshëm diplomën e studimeve (143/16) lëshuar nga Kolegji ISPE (09.06.2016) në Prishtinë.

▶ Albesian Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Elbasan Destani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Dy Dëshmorët" Pirane.

▶ Ahmet Jahdauti shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu "Qamil Guranjaku" Kushnin, Has.

▶ Malsor Idrizaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Rezonancës, drejtimi Inspektor Sanitar.

▶ Naim Haliti B.I. me Emri Tregtar: Zyre për Shërbime Juridike - Naim Haliti me seli në Prishtinë shpall të pavlefshme Certifikatën e regjistrimit me Numri Unik Identifikues: 810457409 të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

▶ Xhevat Abdullahi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Nëna Terezë" Vranidoll Prishtinë nga kl. I deri VIII .

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

